



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Kuvendi i Kryeqytetit
Skupstina Glavnog Grada -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Shërbime Publike, mbajtur më 08.02.2023, duke filluar në orën 16:30.

Në mbledhje morën pjesë: Granit Geci, Besnik Mujeci, Diellza Namani.

Mungoi: Dasmor Durmishi, Berat Lahu.

Në mbledhje ishte i pranishëm edhe: Ilirik Musliu drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi zv. kryesuesi i Komitetit z. Granit Geci, me këtë

R E N D TË D I TË S:

1. Miratimi i ekstraktit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Shërbime Publike;
2. Raporti i punës njëvjeçare nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike;
3. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Shërbime Publike

Njëzéri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Raporti i punës njëvjeçare nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Ilirik Musliu, drejtor të pranishmit i informoi lidhur me punën një vjeçare të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, duke u nisur nga mirëmbajtja e monumenteve, fontanave dhe krojeve publike, si dhe funksionalizmin e 2 apo 3 krojeve, të cilat nuk kanë punuar si p.sh. tek shkallët e Qeverisë, tek Bil Clintoni, të cilat i kemi trashëguar të pa funksionalizuara, të cilat tani janë funksionalizuar dhe mirëmbajtja e tyre vazhdon.

Faqe 1 nga 6

Ai në vazhdim ceki edhe renovimin dhe riparimin e ashensorëve, që është një prej kërkesave të shumta që i kemi prej qytetareve, ku diku janë 73 kërkesa që i kemi trashëguar ndër vite e që nuk kanë pas mundësi me u trajtuar, realisht edhe buxhetin që e kemi trashëguar vitin e kaluar, ka qenë buxhet që kemi pas mundësi me i përfunduar gjashtë ashensorë.

Pastaj rregullimi i lokacioneve siç janë "Dardania", "Sheshi Nëna Terezë", "Bregu i Diellit", "Lakrishtë", dhe në "Kompleksin Qafa" i kemi rregulluar dy, d.m.th janë që kanë përfunduar.

Ai mes tjerash tha se realisht nëse shkojmë me këtë trend i bie që vetëm këto kërkesa që i kemi me na shkuar diku 10 apo 12 vite.

Ne e kemi rritur buxhetin e ashensorëve dhe po presim që brenda muajit shkurt të nënshkruhet kontrata e re, i kemi diku 600 mijë euro me të cilën diku 30 mijë euro po sillet një kosto d.m.th po mendoj që 20 ashensor me i përfunduar pak më shpejtë ku janë urgjente, sidomos rastet kur ka hendikep dhe rastet e tilla. Mirëpo mund të ju them se mirëmbajtjen Komuna nuk e bën.

Mundet me qenë NPB-ja, apo ndonjë operatorë privat por që realisht ata janë të kushtëzuar, e kanë obligative mandej me e bërë mirëmbajtjen vit për vit se është investim i madh prej Komunës, mandej ata duhet me e mirëmbajtur dhe është me bashkë financim, aty bashkë financojnë edhe qytetarët.

Besnik Mujeci, duke u ndërlidhur me mirëmbajtjen e ashensorëve tha se në disa vende NPB-ja, nuk kishte pasur mundësi me hyrë, sepse kishte pasur pak banorë, e kishin marrë operatorët e tjerë.

Si dhe shtroi pyetje lidhur me banesat e Aktashit, ku thotë tash nuk e di si janë por më herët i kanë pasur ashensorët tmerr, nuk ke guxuar me hy në ashensor në Aktash.

Ilirik Musliu, drejtor duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Mujeci tha se i kemi një apo dy që me kontratën e re duhet menjëherë me i trajtuar. Janë të tmerrshëm, aty ka pasur edhe incidente që kanë ndodhur në mesin e tyre njëjtë është edhe Dardania.

Ai në vazhdim tha se e kemi bërë vendosjen e rrrethojave në hapësira publike dhe në hapësirat e varrezave në zonat urbane dhe në zonat rurale. Ju keni pasur mundësi me e parë që me rrrethoja i kemi përdorur tri lloje të rrrethojave.

Rrrethoja me ngjyrë të verdhë që keni mundur të i shihni, ajo më shumë është vendosur në hapësirat ku ka pasur të bëjë me sigurinë, d.m.th ndoshta ka qenë ndonjë pjerrinë që ka pas mundësi të bie ndonjë fëmijë, p.sh. në Kolovicë, që e kemi vendosur, d.m.th në rastet e tillë është vendosur rrrethoja e verdhë.

Rrrethoja me ngjyrë të gjelbër është vendosur ku ka pasur gjelbërim, p.sh. në rrugën Tirana.

Rrrethoja me ngjyrë të zezë me hyjneshë është rrrethojë e komunikacionit që është vendosur tek udhëkryqi i Menzës edhe tek "Rrethi me Flamur", tash të gjitha udhëkryqet kryesore do të trajtohen njëjtë.

Tek Menza, ka ndodhur një aksident dhe për fat ka qenë rrrethoja dhe e ka ndalë sepse do të kishte hyre në trotuar, d.m.th me një investim e shpëton një jetë.

Besnik Mujeci, shtroi pyetje lidhur me rrrethojat tek Ministria e Punëve të Jashtme, ku ka qenë EULEX, tha se është shumë barrierë e madhe shumë pengesë për qytetarët dha namio e kogo

Ilirik Musliu, drejtor duke u ndërlidhur me pyetjen e z. Mujeci tha se a është Ministria e Jashtme aty apo kush e ka në menaxhim. Sepse nëse është në nivel qendoror ne nuk kemi kompetencë me ia larguar rrethojën, si me shkuar me ia larguar rrethojën qeverisë, nuk mundemi, nuk është objekt që menaxhohet nga ne.

Ajo që po thoni ju qëndron sepse ajo edhe lëvizjen e këmbësorëve e devijon, shpesh dalin e ecin në rrugë.

Këtu i kemi cekë lokacionet ku janë vendosur rrethojat d.m.th është "Kalabria", rrugë Tirana, "Kolovica e Re", rruga. Aqif Blyta, "Sheshi Nëna Terezë", rruga. Sylejman Vokshi, "Lagja Universiteti", "Lagja Dardania", nënkalimi të Termokosi, Ulpiana rruga. Mujë Krasniqi, Mati rruga. Muhammed Fejza, "Mensa e Studentëve", "Lagjen e Spitalit" dhe parkun e qytetit e kemi bërë së fundi.

Unë tash po flas vetëm për 2022, pak mandej vetëm në pikë të trasha për 2023, se çka ndërlidhet me këto se çfarë kemi bërë vetëm me u treguar e ndoshta është mirë që ju me e thirr një takim tjetër të tillë për me pas mundësi me biseduar për projektet 2023.

Ai mes tjerash tha se kemi punuar në riorganizim të Trafikut Urban. Transporti publik në vitin 2023 për ne ka me qenë vit i transportit publik për shkak të këtyre reformave dhe të gjithë kontratës të kredisë që e kemi nënshkruar, riorganizimin e linjave të reja. D.m.th viti 2023 është vazhdimësi e kësaj se çfarë kemi punuar në 2022. Nëse dëshironi me u thelluar në detaje mundem me u treguar për transportin publik se si do të jetë.

Granit Geci, duke iu drejtuar z. Musliu tha se kisha pasur dëshirë të di diçka për fshatrat.

Feim Osmani, shtroi pyetje se a është ndërhyrë diçka në plan të mobilitetit apo është siç ka qenë.

Ilirik Musliu, sa i përket planit të mobilitetit tha se ai është i mirë, nuk ka dyshim, d.m.th është punuar nga një kompani me shumë famë e krejt në rregull është. Nuk ka faj plani i mobilitetit, por Prishtina, është zhvilluar shumë dhe ai plan i mobilitetit jo krejt përkon me gjendjen aktuale që e kemi, p.sh. plani i mobilitetit thotë së duhet me i pas 161 autobusë, ne në bazë të matjeve që i kemi bërë tani bashkë me BERZH-in, del që minimumi duhet me i pasur 200, tash menjëherë ai 161 po bie.

Ai në vazhdim tha se plani i mobilitetit është shumë i mirë por e ka vetëm një mangësi, transportin publik. Nuk ka pasur faj plani i mobilitetit por esenca ka qenë që nuk ka pasur strategji dhe vizion për transport publik. Nuk e kanë ditur a kanë me mbetur me Trafik Urban krejt, a kanë me mbete me sektorë privat, a ka me qenë gjysmë gjysmë, kjo ka qenë edhe ideja që nuk kanë dhënë licencim për operim. D.m.th ne kur kemi ardhur si administratë e re, unë konkretisht e kam gjetur transportin publik, duke përfshirë Trafikun Urban, pa licencë të operimit, d.m.th. ka qenë autobus i Trafikut Urban, e me e ndal inspeksioni me ia kërkuar licencën e operimit ai nuk ka pasur.

Sektori privat po kuptohet që ka qenë në gjendjen e njëjtë, pa licencë të operimit, e që nuk u ka mundësuar atyre me investuar. D.m.th nuk ka pasur mundësi ai me investuar sepse nuk kanë pas licencë.

Pra kjo është ideja se pse ne sot e kemi një disbalancë në mes flotës të Trafikut Urban dhe sektorit privat, kjo është ajo që e kemi trashëguar.

Plani i mobilitetit parasheh shumë pak transport publik në zonat rurale, përfaktin që edhe aty e ka një logjikë, d.m.th. një arsyetim qëndron mbrapa, sepse kanë thënë që në formatin çfarë është punuar, sepse aty kanë ndihmuar me të dhëna e statistika edhe Banka Botërore, është menduar që derisa plani i mobilitetit me transport publik gjenë shtrirje 100% zonat rurale kanë me u zbrazur.

Ai në mes tjerave tha se vërtet zonat rurale i kemi tmerrësish keq, nuk janë aspak të përfshira mirë në nivelin që duhet me qenë. Kështu që ne kemi me bërë riorganizimin e linjave, shtimin e linjave të reja, mendojmë me ardhur të ai numri 200 i autobusëve e jo 161, bashkë me privat. Ideja është që këta po dëshirojnë 101 me qenë të Trafikut Urban, 99 me qenë privat, qysh është menduar atëherë me qenë 81 me 80, tash 101 me 99.

Ne e kemi nënshkruar kontratën e re, vijnë 30 autobusë, prej tyre 6 janë elektrik. Këta 6 elektrik kemi me i vendosë me i shfrytëzuar në këtë zonën Qendër, në unazën kryesore, me qëllim të ruajtjes së ambientit.

Në diskutim e sipër u cek edhe çështja e çmimores së biletave dhe kush është i liruar nga pagesa e ata janë: Fëmijët deri në moshën 7 vjeçare, personat me aftësi të kufizuara, veteranët me status, veteranët e UÇK, familjarët e dëshmorëve të zhdukur të luftës, pensionistët e Komunës së Prishtinës, pjesëtaret e Forcës së Sigurisë, Policia e Kosovës, zjarrfikësit, nxënësit e shkollave fillore të Komunës së Prishtinës.

Feim Osmani, tha se kur e përmenda këtë planin e mobilitetit e kisha parasysh që aty thotë p.sh. pjesa veriore e Prishtinës, është një linjë vetëm deri në Besi. Automatisht ne i privojmë që minden me u ankuar edhe në gjyq, Vranidollin, Tenezhdollin, Prugocin, Barileven e të tjera, unë e mora vetëm këtë rrugë pa hyrë në këtë pjesën tjetër.

Andej mundeni me operuar me fitim sepse ka shumë udhëtarë, por pjesa e Gollakut e ngarkon aq shumë ndërmarrjen sa që bleta nuk ka.

Ilirik Musliu, tha se e mira është që ne e kemi fituar atë argument dhe kemi me bërë shtimin e linjave.

Komplet zonat rurale, zona urbane, periferike kanë me qenë e mbuluar me transport publik. D.m.th ne 80% të linjave i kemi gati por nuk po mundemi me e përfunduar të gjithën pa e marrë një konfirmim edhe prej BERZH-it, sepse ashtu është marrëveshja e kredisë, por që realisht janë të gjitha të përfshira d.m.th të gjitha kanë me qenë me transport publik.

Diku parashihet deri 12 milion euro, ka me qenë kostojë vjetore e Komunës, e sa kemi me mbërri mandej me i inkasuar mbetet të shihet.

Feim Osmani, tha se që të bëhet një plan i mirë, unë mendoj që këtu duhet të jetë parasysh edhe numri i vijave dhe numri i qarkullimit të autobusëve, me i marrë parasysh zonat që kanë më shumë urbanizëm, me qenë më shpesh zonat që janë ekstra rurale.

Ku në vazhdim tha se për shembull kjo linja kryesore deri në Tenezhdoll, mendoj që duhet të jetë minimumi çdo gjysmë ore për të plotësuar kërkësën, sidomos kategoria e studentëve dhe e nxënësve mos me pasur probleme, e këto pjesët tjera mbulohen.

Besnik Mujeci, shtroi pyetje se në Fushë Kosovë, a e kemi vetëm Komuna e Prishtinës, apo e ka edhe Fushë Kosova.

Ilirik Musliu, lidhur me pyetjen e z. Mujeci tha se në Fushë Kosovë është projekt i Bankës Botërore.

Komuna e Prishtinës, Banka Botërore dhe Ministria, jemi s' bashku duke e bërë por akoma ka mbete që ministri Liburni me vendosë se cili ka me qenë formati.

Ai në vazhdim tha se Banka Botërore i ka dy propozime, dy projekte.

E para, është me qenë autobusët në mes, siç janë në Stamboll, stacionet janë me nënkalim, hyn në nënkalim del në stacion në mes, hyn në autobus dhe më nuk ndalesh sepse ashtu është e dedikuar, e mbyllur.

E dyta, është më e lirë dhe është me e bërë anësore, anash, mos me qenë e bllokuar, infrastruktura ekzistuese me u shfrytëzuar por me qenë "Bus Line" d.m.th me qenë e dedikuar për autobusë, por me vetëdijen që e kemi ne është pak problem. Kështu që me shumë mundësi ka me u bërë e para, ajo në mes. Hyn në Fushë Kosovë dhe vjen deri në hyrje këtu, e pastaj ata kanë me e bërë një lidhje me Stacionin e Autobusëve dhe për 5 minuta mbërrin nga Fushë Kosova në Prishtinë.

Ndërsa sa i përket planit të mobilitetit tha se besoj që veç se e dini që e kemi një Task Forcë, që operon në kuadër të Komunës, kjo është bërë me vendim të kryetarit.

Në kuadër të Task Forcës ne i kemi bërë disa rekomandime, p.sh. rrëth rrotullimi, rregullimi i qarkullimit në rrugën tek hekurudha që është në drejtim të rrugës magjistrale M2 Mitrovica-Prishtina, ajo është kthyer në rrugë dy kahore prej një, po presim tjetra me u bërë nën urë. d.m.th rekomandimin tjetër që e kemi dhënë është që prej rrugës Tirana, kur del aty tek zalli me e pas mundësinë me hyrë nën urë dhe me dal me u lidhë drejt me Fushë Kosovë.

Besnik Mujeci, shtroi pyetje se varrezat e serbëve a na kanë bërë problem neve, a na pengojnë.

Ilirik Musliu, lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Mujeci tha se jo nuk na pengojnë, pasi që aty edhe ne kemi punuar, i kemi larguar disa mbeturina, dhe e kemi parë që aty ka asfalt, ajo më herët kishte qenë rrugë që unë nuk e mbaj mend por ishte e qartë që ka asfalt, pak se gati është, vetëm kemi me vazhduar me e lidhë me atje dhe del direkt.

Ai në vazhdim tha se kemi bërë testimin dhe analizën e qarkores, e dini ato tri që i kemi bërë. Mandej e kemi bërë rekomandimin për ndërlidhjen e "Kalabrisë" me "Dardaninë", tek stacioni i autobusëve.

Kemi bërë implementimin dhe vendosjen e parkingjeve për biçikleta në pjesën urbane, të "Bill Clinton", të "Zahir Pajaziti", në "Park të Qytetit" dhe në lagjen e "Muhaxherëve", po ashtu edhe në "Parkun Gërmia".

Dhe shtyllat antiparking dhe pistonat lëvizës që i kemi bërë me shenjëzim.

E kemi bërë projektin e sigurisë në shkolla, keni pas mundësi me i parë ato ngjyrat që i kemi bërë në shkollat "Hasan Prishtina", "Xhemail Mustafa", "Dardania", "Gjergj Fishta", "Gjin Gazulli", "Zenel Hajdini", "Afrim Gashi" dhe "Shkëndija" në Hajvali.

Diellza Namani, ngriti shqetësimin lidhur me qentë endacak si dhe a keni pasur takime me fondacionin e kafshëve "Elzën", si dhe kur do të bëhet strehimorja e tyre.

Ilirik Musliu, duke iu përgjigjur znj. Namani tha se ne e kemi nënshkruar një marrëveshje dhe realisht unë mendoj që kryetari i ka dhënë më shumë se sa që duhet kompetenca asaj. Ai mes tjerash tha se vetëm mi dërgoni pikat, unë vetëm i dërgoj në grup. Ne ku kemi kërkesa i dërgojmë fotot, ata i kthejnë mbrapa me qentë të cilët i kanë marrë dhe i kanë trajtuar. Kjo është procedura.

Ai mes tjerash ceki edhe çështjen e Terasave dhe kafiqëve, në Prishtinë të cilat janë jashtë rregullores, d.m.th asnjë nuk është brenda rregullores së Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Rregullorja e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, thotë që duhet me qenë çadra lëvizëse dhe xhamat duhet të jenë lëvizëse.

Ku unë i kam treguar Kryetarit Rama sepse më ka pyetur disa herë, dhe tani mbetet që Kryetari Rama, kur dëshiron me marrë vendim sepse nuk është lehtë.

Sheshit ka filluar, "Kafet e Vogla", i ka njëjtë, "Rrugën B" e ka njëjtë. Ne si Drejtori e Shërbimeve Publike e kemi kryer punën tonë. Raporti të cilin e kam kërkuar është që secila leje para se me u lëshuar, është kërkuar skica se si është gjendja aktuale, dhe ka thënë që është zero.

Pra si përfundim pas shumë diskutimesh e sugjerimesh nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike **Ilirik Musliu** të pranishmëve u tha se do i vendosim këto në laptop dhe të gjitha prezantimet e të gjithë sektorëve hyjmë i shikojmë një nga një, që ndërlidhen me projektin dhe buxhetin e viti 2023.

Mbledhja përfundoi në orën 18:00

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesi i Komitetit
Granit Geci

